

Thirrja është e hapur nga data 07.12.2022 deri me 13.12.2023

TERMAT E REFERENCES

Ekspert/e

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimin e trajnimit.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI
Objektiva	“Përditësimi i politikave të organizatës kundër diskriminimit, përfshirja e barazisë gjinore ne kuadër të statutit dhe rregullores së OJQ Nevo Konceptit. ”

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga Asambleja Komunale e Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 3 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve ne nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulta të komunës së Prizrenit.

3. OBJEKTIVA

OJQ Nevo Koncepti është duke kërkuar një Ekspert/e i cili do të udhëheqë dhe do të realizojë përditësimin e politikave të organizatës kundër diskriminimit dhe përfshirjen e barazisë gjinore në kuadër të statutit dhe rregullores së NVK-së. Punëtorja do të mbahet me Stafin dhe Bordin e OJQ Nevo Koncepti.

4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Eksperti duhet të përpiloj materialin e punëtorisë dhe metodologjinë.
- Të jetë i/e aftë në komunikim dhe interpretim të informatave.
- Të punoj në perputhje me politikën e NVK.
- Të realizoj punëtorinë me temat e lartpërmendura për stafin e NVK.
- Të raportoj për pënetorinë dhe zhvillimin e tij.
- Të përpilojë materialin raportues përfundimtar.
- Të ketë ekspertizë mbi temën e lartëcekur (kandidatët preferohet të kenë qertifikime mbi temën)

5. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me datën 14 Dhjetor deri me 25 Dhjetor 2023. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të punëtorisë	Zhvillimi / adaptimi i programit të punëtorisë, përfshirë matricat e punëtorisë për 'Përditësimi i politikave të organizatës kundër diskriminimit, përfshirja e barazisë gjinore në kuadër të statutit dhe rregullores së OJQ Nevo Konceptit	2	Dhjetor 2023
2	Ofrimi i programit të punëtorisë për Stafin dhe Bordin e OJQ Nevo Koncepti	Ofrimi i punëtorisë 2-ditor për një grup të pjesëmarrësve	2	Dhjetor 2023
3	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimit i raportit përfundimtar mbi 'Përditësimi i politikave të organizatës kundër diskriminimit, përfshirja e barazisë gjinore në kuadër të statutit dhe rregullores së OJQ Nevo Konceptit.	2	Dhjetor 2023
	Gjithsej:		6	

6. REZULTATET E PRITSHME

- Zhvillimi i përmbajtjes së përgjithshme të planit të punëtorisë.
- Përditësimi i politikave të organizatës kundër diskriminimit.
- Përfshirja e barazisë gjinore në kuadër të statutit dhe rregullorës së OJQ Nevo Koncepti.
- Stafi i NVK te jete i informuar lidhur me procesin e punëtorisë.

7. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet ti dërgojnë këto dokumente:

- a) CV / Profili:
- b) Shprehja e interesit.
- c) Oferta financiare
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 13.12.2023** në qylanxhiuelmedin@gmail.com duke e kopjuar (cc) në email o.osmani@nevokoncepti.org.